

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 2225 Prot

Peshkopi, më 24. 06.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.36


Datë: 20.06.2024

“Për miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2023”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.509/1 prot.

Peshkopi, më 25.06.2024


Lënda: Për vendimin nr.36, datë 20.06.2024 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.36, datë 20.06.2024 “*Për miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2023*”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e financës dhe probleme të ngjashme me to, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre, të cilat në kuptim të nenit 13, pika 5, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, janë subjekte kontrolli nga KLSH-ja.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 36 Datë 20/06/2024

“Për miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2023”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, 18, 34, 40, 41, 54, shkronja “dh”, 55 pika 3, kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 44, pika 4, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhmin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.120 datë 22.12.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin, nr.19/1 prot datë 11.01.2023 i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **20.06.2024** me 16 vota pro, 0 kundër dhe 4 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e realizimit të buxhetit të Bashkisë Dibër për vitin 2023.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **20.06.2024**.

Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mario FEJZA

